



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.87/2 prot.,

Datë 16.01.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “T & XH” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-88456-11-21-2023, me objekt “Rikualifikim i ambjenteve të jashtme” me fond limit 22,0000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.12.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Porti Detar Sarandë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “T & XH” SHPK me NIPT L72121504I dhe adresë: Rr. Kongresi i Manastirit, ZK 8514, Pasuria nr. 1/432, Hyrja-1 (Prane Kapedanit)
- Autoriteti Kontraktor:** SH.A Porti Detar Sarandë me adresë: Rruga “Mitat Hoxha”, Lagjia nr.4, Sarandë

Në datën 15.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar ankesa me nr.87 prot., e operatorit ekonomik “T & XH” SHPK për procedurën e “E hapur” me Nr. REF-88456-11-21-2023, me objekt “Rikualifikim i ambjenteve të jashtme” me fond limit 22,0000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.12.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Porti Detar Sarandë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “T & XH” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “T & XH” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Subjekti T&XH shpk nuk permbush piken 2.3.9 te DST, konkretisht: • Nuk ka paraqitur certifikatën CE ose raporte testimi për bojën bikomponente të vijëzimit, i cili duhet te vertetoje Standartin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “Materialet per vijezimet horizonatale ne rruge- Metodat labaratorike ne identifikim”, ose ekuivalentin e tij.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.01.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri